VENDIM
Nr. 525, datë 20.7.2016

PËR FINANCIMIN NGA FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT TË FAZËS PËRGATITORE TË PROJEKTIT TË BANKËS BOTËRORE "PËR ZHVILLIMIN E INTEGRUAR URBAN DHE EKONOMIK"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", dhe të neneve 6, pikat 2, shkronja "a", e 4, si dhe 8, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 10130, datë 11.5.2009, "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Financimin në vlerën 70 000 000 (shtatëdhjetë milionë) lekë të kostove për hartimin e disa projekteve teknike, si dhe të disa projekteve konceptuale-vizionare për zonat e Jugut të Shqipërisë, përfituese në kuadër të fazës përgatitore të projektit "Për zhvillimin e integruar urban dhe ekonomik", që do të financohet nga Banka Botërore dhe do të zbatohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

2. Vlera prej 70 000 000 (shtatëdhjetë milionë) lekësh të përballohet nga buxheti i Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe do të shtrihet në dy vite, si më poshtë vijon:

a) 56 000 000 (pesëdhjetë e gjashtë milionë) lekë, për vitin 2016;

b) 14 000 000 (katërmbëdhjetë milionë) lekë, për vitin 2017.

3. Efekti financiar sipas shkronjës "a", të pikës 1, të përballohet nga buxheti i miratuar për vitin 2016 për Fondin Shqiptar të Zhvillimit.

4. Efekti financiar sipas shkronjës "b", të pikës 1, të parashikohet në projektbuxhetin e vitit 2017 për Fondin Shqiptar të Zhvillimit.

5.. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi